



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 414 Prot
Nr. 2125/1 Dosje

Tiranë, më 04.05.2021

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë, Florian Shehu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, pranë Shoqërisë së Përmbarimit “TDR GROUP” sh.p.k, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.874, të lëshuar me datë 04.02.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2125/1, Datë 13.04.2021 kërkesën e kreditorit Shoqëria “VEIZI CASH & CARRY” Sh.p.k me NIPT L92606806H ndaj debitorit Shoqëria “LE FISH” Sh.p.k me NIPT L82208033A në lidhje me titullin ekzekutiv Faturë Tatimore Shitje Nr. Serie 74921707, datë 08.04.2019.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar palës debitore Lajmërimin Nr.344 Prot, Datë 14.04.2021, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhëri i Ekzekutimit Nr.874, datë 04.02.2021, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA

Se pala debitore ka marrë njoftimin sipas parashikimit të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Civile të Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi aksionet e debitorit Shoqëria “LE FISH” Sh.p.k me NIPT L82208033A, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Per sa me sipër, në referim të Ligjit Nr.26/2019 “Per Sherbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,



Shoqëria Përmbarimore Gjyqësore Private “TDR Group”sh.p.k
Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta” Kulla Nr. 5 ,Kati i 11-të , Nr.54 Tiranë
Tel : 00355 42 427790
www.tdr.al

URDHËROJ

1. Vendosi e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga debitori:
 - **Shoqëria “LE FISH” Sh.p.k me NIPT L82208033A**
2. Pas vënies së masës së sekuestros, te informohemi ne lidhje me:
 - a) adresen e ushtrimit te veprimtarise private.
 - b) llojin e aktivitetit per te cilin eshte pajistur me licence.
 - c) bllokimin e shitjes se aksioneve dhe tjetersimit te aktivitetit.
3. Per veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini ne dijeni shkreserisht brenda afatit ligjor.
4. Personat që behen pengese, do te pergjigjen ne baze te nenit 606 te K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit te gjobes dhe kallzimin penal.
5. Kjo kerkese perpilohet dhe mbahet ne disa kopje.

SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT “TDR GROUP” sh.p.k.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

